POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit
1 Grabitje spektakolare në Itali/ Grupi kriminal sulmon automjetin e blinduar brenda tunelit, vjedhin 2 milionë euro! Dogjën dy mjete për të bllokuar trafikun (VIDEO)
2 VIDEOLAJM/ Ishte duke ecur në Lungomare, qentë endacakë sulmojnë një person në Vlorë
3 FOTOT/ Me orë 1.5 mln euro, reperi i njohur Mozzik arrestohet në aeroportin e Prishtinës, reagon këngëtari dhe mohon pretendimet
4 'Motra jote është paguar'...pas komenteve negative për Beatrix, vëllai i saj, Albani merr vendimin që pritej
5 Dorë për dore me Donaldin, Bora Zemani na zbulon prapaskenat e 'Dancing With the Stars'

Kronikë

Vritet me 2 plumba në kokë biznesmeni në Elbasan, u qëllua në karburantin e tij sapo hipi në 'Range Rover' (EMRI+FOTO+VIDEO)

Biznesmeni Mondi Mëhalla u qëllua pasi kishte dalë nga zyra e karburantit dhe ishte futur në automjetin e tij. Autorët kanë qëlluar disa herë me pistoletë në drejtim të tij, ndërsa dy prej plumbave e kanë goditur në kokë. 43-vjeçari me precedentë të mëparshëm kriminal.

- Kush është Mondi Mëhalla, pronari i një karburanti dhe rrjeti taksish! Në gjyq për armëmbajtje pa leje
- VIDEO/ E motra qan dhe ulëret, të afërmit mbërrijnë në vendngjarje
- Si u ekzekutua biznesmeni në Elbasan, u qëllua sapo doli nga zyra dhe u fut në makinë!
- FOTOLAJM/ Ja shenjat e plumbave në Range Rover-in ku u ekzekutua biznesmeni në Elbasan
- Report Tv sjell pamjet, Range Rover-i ku u ekzekutua Mëhalla ende në vendin e ngjarjes

Redaksia
30 Nëntor, 21:12 | **Përditesimi: 1 Dhjetor, 10:28**
Share

Një biznesmen u ekzekutua me armë zjarri mbrëmjen e sotme rreth orës 20:35 në lagjen "Emiri Metraxhiu" në Elbasan.

Edmond Hyka alias Mondi Mëhalla, 43 vjeç, u vra me 2 plumba në kokë brenda makinës së tij tip "Range Rover", në karburantin "Xhaxhi Oil" në pronësi të tij, në dalje të Elbasanit.

Gjithashtu, biznesmeni i ekzekutuar ishte edhe pronar i një shërbimi taksi në qytetin e Elbasanit, i quajtur "El Taxi". 43-vjeçari jetonte në Tiranë, te Komuna e Parisit.

LEXO EDHE:
Ekzekutimi i 43-vjeçarit Mëhalla në Elbasan, 7 të shoqëruar! Mjeti i autorëve gjendet i djegur në Librazhd, brenda edhe pistoleta e krimit (VIDEO)

Sipas deklarimeve nga vendngjarja dhe pamjeve të kamerave të sigurisë, biznesmeni sapo kishte dalë nga zyra e karburantit dhe ishte futur në automjetin e tij. Autorët kanë qëlluar disa herë me pistoletë në drejtim të tij, ndërsa dy prej plumbave e kanë goditur në kokë.

Mondi Mëhalla ishte në gjyq për armëmbajtje pa leje, posedim të sendesh të jashtligjshme dhe shpërndarje narkotikësh. 1 vit më parë atij i është gjetur shkop gome.

Edmond Hyka alias Mondi Mëhalla

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Me rreth të kuq, Range Roveri ku u vra Mondi Mëhalla

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT

QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "PERSON FIZIK"

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS)	L32712206V
2. Emri i subjektit	Mondi Mëhalla
3. Forma ligjore	Person Fizik
4. Data e regjistrimit	12/03/2013
5. Fusha e veprimtarisë	Shitje-blerje automjetesh te perdorura.
6. Vendi i ushtrimit të aktivitetit	Elbasan Labinot fushe MENGEL Rruga Elbasan-Librazhd, zk.2654, pasuria nr.A & B.
7. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit	
8. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: HOLLYWOOD LOUNGE BAR E-Mail: brunilda.mehalla@yahoo.com Telefon: 0699762616
9. Statusi	Pezulluar

Datë:01/12/2025

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 23:40

FOTOJA e biznesmenit të ekzekutuar në Elbasan me 2 plumba në kokë

Personi që shihni në foto është biznesmeni Edmond Hyka alias Mondi Mëhalla, 43 vjeç, i cili u vra me 2 plumba në kokë brenda makinës së tij tip "Range Rover", në karburantin "Xhaxhi Oil" në pronësi të tij, në dalje të Elbasanit. Gjithashtu, biznesmeni i ekzekutuar ishte edhe pronar i një shërbimi taksi në qytetin e Elbasanit, i quajtur "El Taxi". 43-vjeçari jetonte në Tiranë, te Komuna e Parisit.

Ngjarja ka ndodhur rreth orës 20:35 të mbrëmjes dhe bazuar në deklarimet nga vendngjarja dhe kamerat e sigurisë, biznesmeni sapo kishte dalë nga zyra e karburantit dhe ishte futur në automjetin e tij kur është qëlluar.

Autorët kanë qëlluar disa herë me pistoletë në drejtim të tij, ndërsa dy prej plumbave e kanë goditur atë në kokë duke i shkaktuar vdekjen e menjëhershme.

Report tv mëson se ai ushtronte aktivitetin e tij të biznesit në qytetin e Elbasanit, por jetonte në Tiranës në zonën e Komunës së Parisit.

K.M/Shqiptarja.com

Share

Ora 23:23

Hiqet nga vendngjarja 'Range Roveri' i biznesmenit që u ekzekutua sonte në Elbasan (VIDEO)

Është hequr nga vendi i ngjarjes, për t'u dërguar në Komisariatin e Elbasanit, makina tip "Range Rover" brenda së cilës u vra Edmond Hyka alias Mondi Mëhalla. Atentati ndodhi mbrëmjen e sotme rreth orës 20:35 në lagjen "Emiri Metraxhiu" në Elbasan. 43-vjeçari u vra me 2 plumba në kokë, në karburantin e tij "Xhaxhi Oil".

K.M/Shqiptarja.com

Share

Ora 22:39

FOTOLAJM/ Ja shenjat e plumbave në Range Rover-in ku u ekzekutua biznesmeni në Elbasan

Me rreth të kuq, shenjat e plumbave në xhamin e makinës

Biznesmeni Mondi Mëhalla u ekzekutua brenda në makinë. Autorët kanë vepruar sapo ai doli nga zyra te karburanti në pronësi të tij. Sapo është futur në makinë për tu larguar, autorët i janë afruar tek xhami në vendin e shoferit dhe mësohet se e kanë qëlluar drejt tij disa herë. Siç shihet edhe në këtë foto të Report Tv, në xham dallohen shenjat e plumbave, 2 prej të cilëve e kapën biznesmenin në kokë.

SI.E./Shqiptarja.com

Share

Ora 22:39

Reagon Salianji: Vrasja e sotme në Elbasan tregon degradimin e rendit dhe sigurisë publike

Ish-deputeti i Partisë Demokratike, Ervin Salianji, ka reaguar për ekzekutimin me armë zjarri të biznesmenit Edmond Hyka alias Mondi Mëhalla, në Elbasan.

Përmes rrjeteve sociale, Salianji shkruan se vrasja e mbrëmjes së sotme në Elbasan tregon degradimin e rendit dhe sigurisë publike.

Reagimi i plotë i Ervin Salianjit:

Vrasja e sotme në Elbasan, pas një serie ngjarjesh kriminale në gjithë Shqipërinë, tregon qartë degradimin e rendit dhe sigurisë publike. Nën qeverisjen e Ramës, vrasjet janë bërë puna më e lehtë, kryhen ku të duan, si të duan dhe kur të duan!

Qeveria që i ka dhënë hov, mbështetje dhe pushtet politik bandave dhe krimit të organizuar. Ka ulur në minimum autoritetin e shtetit dhe respektin për ligjin. Sot, krimi nuk ka më frikë nga shteti, përkundrazi, qytetarët nuk e kuptojnë dot më ku mbaron shteti dhe ku fillon mafia, për shkak të bashkëpunimit politik dhe të favoreve të ndërsjella që marrin grupet kriminale.

Shqipëria është lënë në dorë të bandave, ndërsa qeveria merret me propagandë, fasada dhe luks. Kjo gjendje nuk ndryshon me arsyetime, nuk mbulohet me fjalë, por kërkon reagim dhe ndryshim të menjëhershëm politik, për t'i rikthyer qytetarëve sigurinë dhe shtetit autoritetin.

K.M/Shqiptarja.com

Share

Ora 22:11

Ekzekutimi i biznesmenit në Elbasan, reagon policia: U njoftuam rreth orës...



Policia ka reaguar për vrasjen e Edmond Hykës alias Mondi Mëhalla, 43 vjeç, i cili u ekzekutua me 2 plumba në kokë brenda makinës së tij tip "Range Rover", në karburantin "Xhaxhi Oil" në pronësi të tij, në dalje të Elbasanit.

Njoftimi i plotë i policisë:

Rreth orës 20:35, është marrë njoftim se në lagjen "Emin Matraxhiu", brenda në një automjet të parkuar, është gjetur, i vrarë me armë zjarri, shtetasi M. M. alias E. H., 43 vjeç.

Në vendngjarje shkuan menjëherë shërbimet e Policisë dhe janë ngritur pika kontrolli në dalje të qytetit, dhe vijojnë kontrollet në zonë e në ambiente të ndryshme, për kapjen e autorit/ëve.

Ndërkohë, është ngritur një grup i posaçëm hetimor, i cili, nën drejtimin e Prokurorisë, po punon intensivisht për sqarimin e rrethanave, dokumentimin ligjor, si dhe për identifikimin dhe kapjen e autoritorëve.

K.M/Shqiptarja.com

Share

Ora 22:05

Kush është biznesmeni që u vra me dy plumba në kokë në Elbasan, pronari i

një karburanti dhe rrjeti taksish! Në gjyq për armëmbajtje pa leje

Biznesmeni Mondi Mëhalla u ekzekutua me 2 plumba në kokë pranë biznesit të tij mbrëmjen e sotme në Elbasan. Mëhalla, 43 vjeç, rezulton pronar i një karburanti në Elbasan, Xhaxhi Oil, aty ku edhe ka ndodhur ngjarja. Po ashtu, Mëhalla ishte edhe pronar i një rrjeti taksish po në qytetin e Elbasanit, El Taxi. Në pamjet nga vendi i ngjarjes, dallohen disa prej taksive të parkuara tek karburanti ngjitur me Range Rover-in ku u vra 43-vjecari.

Ai nuk është person i panjohur për blutë e Elbasanit. Ai rezulton i skeduar më parë për shpërndarje narkotikësh dhe armëmbajtje pa leje. Siç sqarojnë burime për Report Tv, Mëhalla ishte në gjyq për armëmbajtje pa leje dhe sende të ndaluara. 1 vit me parë atij i është gjetur shkop gome. Ai njihet ndryshe edhe me emrin Edmond Hyka.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	M52909203O	
2. Data e Regjistrimit	09/05/2025	
3. Emri i Subjektit	EL TAXI SHPK	
4. Forma ligjore	SHPK	
5. Data e themelimit	24/04/2025	
6. Kohëzgjatja	Nga: 24/04/2025	
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Elbasan Elbasan Elbasan Lagjja Emin Matraxhiu, rruga nacionale Elbasan-Librazhd, objekti ne zk nr 2654, nr pasurie 7/1.	
8. Kapitali	10.000,00	
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	100,00	
9. Objekti i aktivitetit	Dhenie me qera e mjeteve te transportit rrugor si vetura, motorr, minibus etj, brenda dhe jashtë Shqipërisë. Veprimtari Import - Eksport, shitje dhe blerje e mjeteve motorrike. Kryerjen e shërbimeve, riparimeve dhe mirëmbajtjen e mjeteve	
10. Administratori/ët	Mondi Mëhalla	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 24/04/2025	Deri: 23/04/2030
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Ortakët	Mondi Mëhalla	
12.1 Vlera e kapitalit	Para: 10.000,00	Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	1,00	
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	100,00	
*Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse një		

1

Kliko këtu për të lexuar dokumentin e plotë

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	M12808201J	
2. Data e Regjistrimit	08/04/2021	
3. Emri i Subjektit	MEHALLA-OIL	
4. Forma ligjore	SHPK	
5. Data e themelimit	08/04/2021	
6. Kohëzgjatja	Nga: 08/04/2021	
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Elbasan Elbasan ELBASAN Lagjja Emin Matraxhiu, Rruga Nacionale, objekt privat me zone kadastrale 2654, nr pasurie 7/1.	
8. Kapitali	100.000,00	
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	1,00	
9. Objekti i aktivitetit	Import - Eksport, tregtim me pakice te gjithe games se produkteve petroliere, duke perfshire nafte, benzin, gaz LPG dhe nenproduktet e tyre. Import eksport te shitblerjeve te automjeteve te perdorura, pjese kembimi te automjeteve, servis automjetesh, vajra lubrifikante, bar-restorant, fast – food, lavazh. Transport kombetare dhe nderkombetare te mallrave te ndryshem per vete dhe per te trete.	
10. Administratori/ët	Mondi Mëhalla	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 08/04/2021	Deri: 08/04/2026
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Ortakët	Mondi Mëhalla	
12.1 Vlera e kapitalit	Para: 100.000,00	Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	1,00	

1

Kliko këtu për të lexuar dokumentin e plotë

SI.E./Shqiptarja.com

Share

Ora 22:05

E motra qan dhe ulëret, të afërmit e biznesmenit të ekzekutuar në Elbasan mbërrijnë në vendngjarje (VIDEO)

Report Tv ju sjell pamjet e momentit kur familjarët e biznesmentit 43-vjeçar Edmond Hyka alias Mondi Mëhalla që u ekzekutua mbrëmjen e sotme në Elbasan, mbërrijnë në vendin e ngjarjes. Në video, duket e motra e viktimës, e cila shpërthen në të qara dhe ulërima për humbjen e të vëllait.

K.M/Shqiptarja.com

Share

Ora 21:47

Vrasja e biznesmenit në Elbasan, Report Tv sjell pamjet, Range Rover-i ku u ekzekutua ende në vendin e ngjarjes

Report Tv sjell pamjet nga vendi ku ndodhi ekzekutimi i biznesmenit Mondi Mëhalla në Elbasan. Ai u qëllua me armë në karburantin e tij "Xhaxhi Oil". Në pamje dallohet ende në vendin e ngjarjes mjeti luksoz, Range Rover, ku u vra Mëhalla.

Po ashtu, në pamje shihen edhe disa taksi, El Taxi, rrjet i cili ishte në pronësi të Mehallës.

SI.E./Shqiptarja.com

Share

Ora 21:38

Si u ekzekutua biznesmeni në Elbasan, u qëllua sapo doli nga zyra dhe u fut në makinë! 2 plumba e kapën në kokë

Biznesmeni Mondi Mëhalla u gjet i vrarë mbrëmjen e sotme brenda një mjeti pranë karburantit të tij në Elbasan. Sipas deklarimeve nga vendngjarja dhe pamjeve të kamerave të sigurisë, biznesmeni sapo kishte dalë nga zyra e karburantit dhe ishte futur në automjetin e tij. Burime për gazetarin e Report Tv, Sokol Dema bëjnë me dije se autorët kanë qëlluar disa herë me pistoletë në drejtim të tij, ndërsa dy prej plumbave e kanë goditur në kokë.

SI.E./Shqiptarja.com

Share

K.M/SI.E./Shqiptarja.com

TAG: El Taxi | Xhaxhi Oil | Mondi Mëhalla | Elbasan | vrasje | vrasja e mondi mehallles

Komento

Komente

Gaxhaj: 01/12/2025 09:23

Habitem si ka mundesi qe ska pas polici aty se mbrem ka qene trafik i papare se u kthenin njerzit nga korca dhe ishin rruget totalisht te bllokuara . Policia e krimit, policia e bandave ,fitojne leke duke marr jet njerzish,shtet i poshter i keq .

Përgjigju

EruEri: 01/12/2025 08:04

Koka ben koka peson.....

Përgjigju

Populli: 01/12/2025 07:36

Nuk pati nej karratrec me marre makinen.....

Përgjigju

gezimu: 01/12/2025 04:42

Epo kurdo ndodhin ngjarje të tilla të lutemi tek Zoti që mos të kemi viktima të pafajshmë në kalimtarët

Përgjigju

bei: 01/12/2025 03:23

KJO ESHTE SHQIPERIA E EDI RAMES..PTU.RRACE E POSHTER.....

Përgjigju

Uljan shpataraku: 30/11/2025 23:56

Policia e Elbasanit duhet shkrire dhe ne vend te policise duhet te ngarkohet ushtria qe te mbroje qytetaret.

Përgjigju

Pilu: 01/12/2025 04:23

Lale, nuk kemi ushtri. Ca na le fare pa keta horra tani

Altini: 30/11/2025 22:56

Policia ka degraduar, te gjithe shefat e prodes e kane mendjen te lojrat e fatit, shperndarja e kokaines e ndonje ndertim paleje bejne ndonje leke. Ishte shume me mire para policia se sa e katandisi proda. Po mblidhet nje tension social qe diku do te shpertheje

Përgjigju

Pomepo: 30/11/2025 22:55

Ktu Ka mbaru cdo gjet. Mir e bejn njerezit qe ikin nga ai vend.

Përgjigju

Gjergji: 30/11/2025 22:03

Policia e paska kryer detyren, se e paska kapur viktimen ca kohe me pare me send te paligjshem, nje shkop gome E pershendes policine shqiptare nga Marakeshi i Marokut!!!

Përgjigju

Kalaja: 30/11/2025 22:01

Me cilin grup ishte ky biznesmeni

Përgjigju

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH COM

Sondazhi i ditës: 25 Nëntor, 12:21

Si po iu duken protestat e përjavshme të PD-së para Kryeministrisë?

Të duhura | Të dështuara | Nuk kam mendim

Lajme të tjera

Trishtim në futbollin shqiptar, ndërron jetë lojtari 15-vjeçar i Elbasanit

30 Nëntor, 19:19

Trafik i rënduar në aksin Librazhd-Elbasan, shkak punimet përgjatë rrugës (VIDEO)

30 Nëntor, 17:56

Drift dhe parakalim të gabuar, policia ndëshkon 3 shoferët! Gjobë të majme për motoristin pa skafandë (VIDEO)

30 Nëntor, 16:10

Elbasan/ Të shtënat me armë zjarri në drejtim të banesës së 66-vjeçarit, konflikti nisi mes dy personave! 2 të tjerë të shpallur në kërkim

30 Nëntor, 14:04

Rriten taksat në Elbasan, Llatja: Kemi shumë shpenzime! Opozita voton kundër: Tarifim i padrejtë

Ronaldo Gjoshi

29 Nëntor, 15:38

81-vjetori i Çlirimit të Atdheut përkujtohet edhe në Elbasan, ceremoni solemne në varrezat e Dëshmorëve (VIDEO)

29 Nëntor, 11:48

Elbasan/ Qytetari alarmon policinë për të shtëna pranë një banese, nuk gjenden gëzhoja! Dyshohet për një konflikt, disa të shoqëruar (VIDEO)

28 Nëntor, 23:28

Elbasan/ Aksident pranë tunelit të Kërrabës, përplasen 7 makina, bllokohet qarkullimi

28 Nëntor, 18:31

Elbasanit feston 113-vjetorin e Pavarësisë, kryebashkiaku: Dinjiteti dhe vullneti janë më të fortë se çdo pengesë! Demokrati: Sot nuk janë më ato burra shteti

28 Nëntor, 15:18

Bashkia Përrenjas feston 113 vjetorin e pavarësisë/ Kryebashkiaku: 28-29 Nëntori ditë reflektimi! Deputeti i PS: Të ndihemi krenarë për historinë

28 Nëntor, 13:45

Elbasan/ Ishte në arrest shtëpie, Apeli rikthen në qeli 63-vjeçarin për të shlyer edhe 7 muaj burg! Në 2022, u arrestua se fshihte në banesë Talo Çelën

28 Nëntor, 13:18

Ndërhyri në sistemin e gjobave në favor të personave të tjerë, AMP pezullon nga detyra efektivin e Elbasanit

27 Nëntor, 15:26

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje